

PROGRAMI I MBËSHTETJES SË MJEDISIT, SHQIPËRI
FORCIMI I KUADRIT STRATEGJIK, LIGJOR, INSTITUCIONAL DHE
FINANCIAR PËR PROCESIN E ANËTARËSIMIT NË BE NË FUSHËN E
MJEDISIT DHE NDRYSHIMEVE KLIMATIKE (KAPITULLI 27)
Konteksti

Pruga e Shqipërisë drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian kërkon përafrim të plotë me acquis të BE-së për mjedisin dhe ndryshimet klimatike (Kapitulli 27), kapitulli më kompleks dhe me kërkesa më të larta investimi në procesin e negociatave. Megjithëse Shqipëria ka bërë përparim në transpozimin legjislativ, zbatimi mbetet në faza të hershme dhe përballet me sfida të tilla si fragmentimi i përgjegjësiwe institucionale, kapacitete të kufizuara administrative, mekanizma të dobët koordinimi dhe mungesë planifikimi afatgjatë të investimeve. Sektorë kyç mjedisorë, përfshirë cilësinë e ajrit, menaxhimin e ujërave dhe ujërave të ndotura, mbetjet dhe ekonominë qarkulluese, mbrojtjen e natyrës, ndotjen industriale, kimikatet, zhurmën dhe ndryshimet klimatike, kërkojnë reforma të koordinuara, planifikim të zbatimit me periudha tranzitore dhe investime të konsiderueshme publike. Në këtë kontekst, Programi i Mbështetjes së Mjedisit (ESP) ofron asistencë teknike të synuar për të mundësuar përmbushjen e kërkesave të anëtarësimit në BE përmes planifikimit strategjik të integruar, forcimit të strukturave të qeverisjes dhe mekanizmave të qëndrueshëm financiarë.

Objektivat e projektit

Objekti i përgjithshëm i ESP është të mbështesë Qeverinë e Shqipërisë në përmbushjen e kërkesave të anëtarësimit në BE në fushën e mjedisit dhe ndryshimeve klimatike (Kapitulli 27).

Objektivat specifike përfshijnë:

- Zhvillimin e një strategjie dhe kuadri politik ndërsektorial kombëtar për mjedisin dhe ndryshimet klimatike, në përputhje me kërkesat e BE-së dhe prioritetet kombëtare të zhvillimit;
- Mbështetjen e transpozimit të plotë të acquis mjedisor të BE-së përmes planifikimit të strukturuar dhe forcimit të kapaciteteve institucionale;
- Forcimin e sistemeve institucionale dhe administrative në nivel qendror dhe vendor për të siguruar zbatim dhe mbikëqyrje efektive;
- Përgatitjen e një strategjie kombëtare financiare për mjedisin, për të adresuar nevojat e larta për investime dhe përputhshmërinë me standardet e BE-së;
- Përmirësimin e koordinimit ndërinstitutional, përfshirjen e palëve të interesit dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të reformave.

Komponentët Kryesorë dhe Rezultatet

- Kuadri Strategjik dhe Politik: Hartimi i strategjive kombëtare për mjedisin dhe klimën, planeve të zbatimit dhe akteve ligjore mbështetëse.
- Transpozimi i Acquis të BE-së dhe Ngritja e Kapaciteteve: Përgatitja e planit të transpozimit për Kapitullin 27 dhe forcimi i kapaciteteve institucionale përmes trajnimeve dhe mentorimit.
- Forcimi Institucional dhe Administrativ: Përmirësimi i qeverisjes përmes rishikimeve institucionale, zhvillimit të kapaciteteve dhe vlerësimit të nevojave infrastrukturore.
- Planifikimi Financiar dhe i Investimeve: Përcaktimi i prioriteteve financiare për mjedisin, si dhe forcimi i kapaciteteve për zbatimin financiar.

Rreth IKU-t

Që nga viti 1999, Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë fokusohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojmë në qeveri, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim qasjen e publikut në informacion dhe lidhim partnerët e zhvillimit. URI ka punuar me donatorë si USAID, Swiss Cooperation, Ambasada Hollandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Fondacioni Shoqëria e Hapur, etj.



INFORMACION I PËRGJITHSHËM

DONATOR:
Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim (SIDA)

AUTORITET KONTRAKTUES:
Njësia Qendrore e Financimit dhe Kontraktimit (CFCU)

INSTITUCION PËRFITUES:
Ministria e Mjedisit

KOHËZGJATJA:
28 Tetor 2024 – 27 Tetor 2027 (36 muaj)

KONSULENT ZBATUES:
EPTISA Servicios de Ingenieria S.L.
Instituti i Kërkimeve Urbane
KONTAKT:
Zana Vokopola
Drejtor Ekzekutiv

Instituti i Kërkimeve Urbane

Rr. Asim Vokshi, Nd. 14 Hyrja
11, Ap. 56 Tiranë, Shqipëri
Tel.: +355694333808
E : zvokopola@uri.org.al